



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Besa Company Sh.P.K.” të datës 03.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Besa Company Sh.P.K.” të datës 03.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Besa Company Sh.P.K.” (tutje “parashtruesi”) me datë 03.09.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë si vijon:

Me date 14.06.2024, AK ka bere publikimin e Njoftimit mbi VENDIMIN e AK-se, per aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit te ndriqimit publik – LOT 2".

Ku ne si OE jemi shperblyer me kontrate per LOT 2, pasi qe kemi qene tenderi i pergjegjshem me qmim me te lire, por AK e ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave per shkak te disa rrethanave, me date 19.07.2024 permes emailit ([Nexhmi.Makolli@rks-gov.net](mailto:Nexhmi.Makolli@rks-gov.net)), mirepo nuk e ka kerkuar permes platformes kerkesen per zgjatje te afatit ashtu siq e kerkon Rregullorja, por e ka bere permes emailit te tij zyrtari Nexhmi Mekolli. Pra, ne si OE BESA si OE i rekomanduar per kontrate nuk na ka ardh emaili qe AK e ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave. Pas 5 diteve e kemi pare emailin pasi qe emaili i tij ka shkuar ne JUNK, dhe e kemi pare pasi qe ka kaluar afati i caktuar per sjelljen e validitetit.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

Nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës

Sa i përket pretendimeve ankimore duhet sqaruar që kërkesa për vazhdimin e validitetit është dërguar dhe publikuar me rregull nga autoriteti kontraktues. Përndryshe as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës mirëpo pretendon se për shkaqe teknike nuk ka arritur që të lexoj me kohë kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.09.2024



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.